



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:049514

Datë: 01.07.2024

Numri i dokumentit: 05880529

## NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.191/24

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica dhe bashkëpunëtorin profesional Muhamet Musliu, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. Rr., për shkak të veprës penale Vjedhja e Shërbimeve nga nenin 314 paragrafi 1 të *KPRK*-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.82/2024 të dt.07.06.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur më datë 01.07.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Besart Mustafa, përfaqësuesit të palës së dëmtuar A. M. dhe të pandehurit në të njëjtën ditë mori publikisht shpalli dhe përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

### I akuzuari:

**A. RR.**, nga i ati H. dhe nëna H. mbiemri i vajzërisë L., i lindur me ..., me vendbanim në rrugën "Xh. M." në P., me numër personal të letërnjoftimit ..., ka të kryer shkollën fillore, i pa punësuar, i martuar baba i një fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## Ë S H T Ë F A J T O R

### Sepse:

Me datë 14.11.2023, në rrugën "S" në P., në lokalin e të pandehurit si shfrytëzues i energjisë elektrike, gjatë një kontrolli të bërë nga ekipi i kompanisë "KEDS" rezulton se ka siguruar shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla duke shfrytëzuar energjinë në mënyre direktet pa njehsor elektrik, me numër unik të konsumatorit: DPR ..., ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç' rast ndërmarrjes së dëmtuar "KEDS"- i ka shkaktuar dëm material në vlerë 3,113.87 euro -,

- Me këtë i pandehuri ka kryer veprën penale Vjedhja e Shërbimeve nga nenin 314 paragrafi 1 të *KPRK*-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 9, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe nenit 314 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 364, 365, 368, 369, 449, 452 dhe 462 të KPPRK-së, e:

## G J Y K O N

**I.** Të akuzuarin e gjykon me dënim me gjobë në shumë prej **300.00 (treqind/€uro)**, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

**II.** Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë pas afatit prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20€ (njëzet euro), të papaguara do t'i llogaritet 1(një) ditë burg.

**III.** Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

**IV.** Detyrohet i akuzuari që të dëmtuarës KEDS-it, t'ia kompensoj dëmin material në vlerë prej 3.113.87 Euro, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.82/2024 të dt.07.06.2024, kundër të akuzuarit A. Rr., për shkak të veprës penale Vjedhja e Shërbimeve nga nenin 314 paragrafi 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka treguar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar më dt.01.07.2024, në të cilën prezantuan Prokurori e Shtetit Besart Mustafa nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, përfaqësuesit të palës së dëmtuar A. M. dhe i pandehuri.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar i akuzuari deklaroi: Se e pranojë fajësinë, është e vërtetë sikur në aktakuzë, me vjen keq që ka ndodhur ky rast, jam i gatshëm që dëmin pas ekspertizës së bërë nga eksperti që të ia shlyej kompanisë "KEDS" në shumën prej 3.113.87 euro, dhe mos të kem më asnjë problem, njehsori ka qenë në emër të magjes tim A. Rr. mirëpo ai nuk ka të bëjë asgjë me lokalën, e lus gjykatën që të më shqiptoi një dënim sa më të lehtë, jam i pa punësuar, rasti më nuk do të përsëritet, ndërsa përfaqësuesin e Kompanisë "KEDS" e lus që nëse pranon të lidhim një marrëveshje për shumën e dëmit që është në aktakuzë.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi: Nuk pajtohem me këtë pranim fajësie pasi që konsiderojmë se i njëjti ka kryer veprë penale vjedhje e rëndë, prandaj konsiderojmë që është i nevojshëm edhe dëgjimi i ekspertit të elektros, e pas dëgjimit të tij lënda të shkoj në procedurën e ndërmjetësimit.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në

materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i shtetit Besart Mustafa lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, sepse i njëjti është bërë me vullnetin e plotë nga i pandehuri dhe bazuar në shkresat e lëndës, i propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, e në rastin e marrjes së vendimit të ket parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri ndërsa si rrethanë rënduese të marr intensitetin e dashjes.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, mbrojtësit të pandehurit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Vjedhja e Shërbimeve nga nenin 314 paragrafi 1 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës, për çka edhe u shpall fajtor dhe iu shqiptua dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, i vjen keq për rastin, ka premtuar se më nuk do ta përsëris veprën, ndërsa si rrethana rënduese gjykata nuk gjeti, andaj gjykata duke i vlerësuar këto rrethana ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësin e zëvendësimit të dënimit me gjobë, në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 pika 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi obligimin për kompensimin e dëmit palës së dëmtuar është marrë konform nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, bazuar në ekspertizën elektrike të datës 06.06.2024, të punuar nga Msc. Rexhep Hyseni.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par. 2 pika 2.6 dhe 2.9 të KPPRK-së.

Vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë, konform nenit 36 par.3 nën par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal**  
**P.nr.191/24, me dt.01.07.2024**

**Sekretare Juridike**  
**Fatmire Podvorica**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Minir Hoti**

**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.